

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**Forca Tokësore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Infermier	Rep. usht. nr.1040 në FT	Zall-Herr Tiranë	E pacaktuar	Me dosje	Nuk aplikohet	03.03.2021	05.03.2021

Formulari nr.1

1. Pozicioni i punës:	“Infermier”, me pozicion “N/C”, në skuadrën e pare të trajtimit shendetesor, në kompaninë e mbështetjes, në repartin ushtarak nr.1040, në Forcën Tokësore.
2. Kodi i pozicionit:	C2, (Civil II).
3. Reparti/Institucioni:	Reparti ushtarak nr.1040, në Forcën Tokësore.
4. Vendi:	Zall-Herr, Tiranë
5. Paga:	VKM Nr. 202 datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.717 datë 23.06.2009”, “Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar.
7. Data e fillimit të aplikimit:	03.03.2021
8. Data e mbylljes së aplikimit:	05.03.2021
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	- Kërkesë. - Formularin e aplikimit. - Fotokopje të kartës së identitetit. - Diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare, diplomën e shkollës së lartë të noterizuar ose në origjinal. - Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit nëse ka. - Dëshmi profesioni nëse ka. - Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja. - Raport mjeksor. - Fotografi me përmasa 4x6, 2-copë. - Dëshmi penaliteti. - Vërtetim nga gjykata. - Vërtetim nga Prokuroria. - Librezë pune. - Jetëshkrimin CV. - Formularin e vetëdeklarimit.
11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:	- Të ketë shtetësinë shqiptare. - Të jetë jo më pak se 18-vjeç. - Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar. - Të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara. - Të jetë i aftë për punë nga ana shëndetsore. - Të mos jetë dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi. - Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda një viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil II, (C2).
- b. Arsimi: Të ketë kryer arsimin e mesëm profesional ose të lartë infermieru, për specialitetin e kërkuar.
- c. Kualifikimi: Të ketë përvojë pune dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara.
- d. Trajnimi: Të ketë kryer arsimin e mesëm ose të lartë në infermieru.
- e. Eksperienca në punë: Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- f. Gjuha e huaj: 1/1/1/1 sipas STANAG-6001
- g. Kërkesa të tjera specifike:
 - Të ketë kurse kualifikimi për specialitetin e kërkuar.
 - Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: -----.

13. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore: “Infermier”, me pozicion “N/C”, në Kompaninë e Mbështetjes, në repartin ushtarak nr.1040, në Forcën Tokësore, kryen këto detyra dhe mban përgjegjësi:

- Infermieri ka varësi direkte nga komandanti i Qendrës Shëndetësore.
- Te mirëmbaj në gjendje të mirë të gjithë materialet ne përgjithësi dhe ato shëndetësore në vecanti që ndodhen ne seksione.
- Të bëj aplikimin për shpërndarjen e terapisë së pacienteve sipas kartelave dhe recetave mjekësore të lëshuara nga mjeku
- Të mbajë në gatishmëri teknike sipas rregullave të asepsise të instrumenteve, materialeve dhe pajisjet mjekësore që ka në inventar seksioni përkatës (sterilizimi, dezinfektimi etj.)

Përgjegjësitë: Ndjek dhe zbaton detyra të ngarkuara nga Komandanti i Qendrës Shëndetësore të repartit ushtarak nr.1040.

Të ndjekë detyrimet e kompanisë.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3-(tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- Përzgjedhjen paraprake.
- Vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Tokësore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Komisioni, me mbylljen e aplikimeve, verifikon dokumentacionin e aplikantëve nëse ai është i plotë dhe i saktë si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Kandidatët njoftohen nëse janë përzgjedhur ose jo për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- Vlerësimin e dokumentave të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës, të lidhura me fushën përkatëse).

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, kandidatët listohen sipas listë meritës. Pas listimit të 3-tre kandidatëve, i paraqitet autoriteteve kompetente një memo miratuese për përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm.

Me emërimin në pozicionin e punës, do të lidhet kontrata individuale e punës.

Shefi i Degës Personelit
Nënkolonel Dhimitër Selmanaj